

VENDIM
Nr.1102, datë 4.11.2009

**PËR TRAJTIMIN DHE PËRFITIMIN E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE TË
PERSONAVE, QË KANË PËRFITUAR AZIL, DHE TË PERSONAVE, QË KANË
APLIKUAR PËR AZIL, NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 15, pika 2, shkronja “c”, e 21 të ligjit nr.9098, datë 3.7.2003 “Për integrimin dhe bashkimin familjar të personave, që kanë përfitur azil në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të huajt, që kanë përfitur azil në Republikën e Shqipërisë, sipas ligjit nr.8432, datë 14.12.1998 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, gjë që vërtetohet nga autoritetet përkatëse, gëzojnë të njëjtat të drejta si shtetasit shqiptarë, për të përfitur shërbim shëndetësor nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor.

2. Të drejtën për trajtim dhe përfitim të shërbimeve shëndetësore e kanë edhe të huajt, që kanë aplikuar për azil dhe që kanë vendbanim ose vendqëndrim të përkohshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Ngarkohet Ministria e Brendshme të paraqesë në vazhdimësi listën e përditësuar të personave, që kanë përfitur azil në Republikën e Shqipërisë, dhe të atyre, që kanë aplikuar për azil, pranë Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, për pajisjen e tyre me librezën e shëndetit, dokument ky që vërteton të qenurit e tyre të siguruar.

4. Të gjithë të huajt, që kanë përfitur azil në Republikën e Shqipërisë dhe që janë në marrëdhënie pune, kanë të drejtë të sigurojnë, vullnetarisht, veten dhe familjen e tyre me skema të sigurimeve shëndetësore suplementare, për mjekime me kosto të lartë, të cilat nuk mbulohen nga skema e detyrueshme e sigurimeve shëndetësore.

5. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha